



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 949/4 Prot.

Tiranë, më 21.09.2016

VENDIM

Nr. 66, datë 21/9/2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Shoqata “Intelektualët e Rinj Shpresë”, përfaqësuar nga Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 949 Prot., datë 14.09.2016 me objekt, “Ankim për refuzimin ndaj dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Shkodër.

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 16.08.2016 ka kërkuar nga Autoriteti Publik/ Bashkia Shkodër, t'i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, si më poshtë:

- *Kopje të rregullores për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit mbikqyrës në lidhje me shoqërinë “Vllaznia” Sh.a.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr. 192 Prot., datë 15.09.2016, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Bashkisë Shkodër. Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë” është depozituar pranë Autoritetit Publik/ Bashkia Shkodër dhe regjistruar me nr. 10240 Prot., datë 19.08.2016.

Nga ana e grupit të inspektimit u konstatua se Autoriteti Publik/ Bashkia Shkodër nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës nr. 22 të datës 15.07.2016 të Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”.

Pas kontaktit me koordinatorin dhe zyrën e protokollit, punonjëset e protokollit sqaruan se kërkesa e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë” është depozituar pranë Bashkisë Shkodër dhe nga Kryetarja e Bashkisë i është sigluar për ndjekje Z. me detyrë këshilltar

juridik pranë kabinetit të Kryetares së Bashkisë, Z. me detyrë shëf i kabinetit të Kryetares së Bashkisë dhe Z. administrator i “Klubit Sportiv Vllaznia”. Shkresa e

sigluar nga Kryetari Bashkisë nuk iu vu në dispozicionit grupit të inspektimit me argumentin se, dokumentat nga Zyra e protokollit mund të dalin vetëm me kërkesë të prokurorisë.

Lidhur me ankesën e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”, u kontaktua me Z. _____ me detyrë Koordinator për të Drejtën e Informimit, i cili sqaroi se informacioni i kërkuar nga ana e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë” përbën informacion publik, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Gjithashtu, sqaroi se nuk ishte në dijeni për kërkesën e sipërcituar dhe se nuk e ka ndjekur ecurinë e saj, duke dhënë edhe argumentin se në datë 27.08.2016 është larguar për të kryer lejen e zakonshme. Z. _____ u pyet nëse ishte vënë në dijeni për kërkesën për informacion dhe nëse e kishte regjistruar atë në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve konform nenit 8 dhe 18 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Për sa më sipër koordinatori sqaroi se zakonisht për kërkesat për informacion, informohet nga zyra e protokollit por në rastin konkret nuk është informuar.

Lidhur me ankesën e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”, Z. _____, i ngarkuar nga titullarja e Autoritetit Publik për kthimin e përgjigjes, bëri gjithashtu sqarimet përkatëse duke argumentuar se informacioni i kërkuar nga ana e Shoqata “Intelektualët e Rinj Shpresë” përbën informacion publik, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Z. _____ sqaroi se *ishte në dijeni për këtë kërkesë por nuk ka proceduar për të kthyer një përgjigje, në rradhë të parë për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe së dyti për faktin se ky informacion mund të sigurohet lehtësisht në faqen zyrtare të QKR-së, si dhe theksoi se brenda javës së ardhshme (nga data e inspektimit) kërkuessit do ti vihet në dispozicion informacioni i kërkuar.*

Pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit, si dhe pas konsultimit të legjisllacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Shoqata “Intelektualët e Rinj Shpresë”, përbën informacion publik. Në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përbën shkelje administrative ..

Nga inspektimi rezultoi se Autoriteti Publik/ Bashkia Shkodër, nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës për informacion. Gjatë inspektimit, vetë nëpunësi Z. _____ vuri në dispozicion kërkesën e Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë” së bashku me kartelën shoqëruese, ku ai vetë figuron personi përgjegjës për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Nga dokumentacioni vërehet se, kërkesa nuk është trajtuar nga personi i sipërcituar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në rastin objekt shqyrtimi konstatohet se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin parësor dhe më të rëndësishëm të parashikuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilës duhet të trajtonte kërkesën brenda afatit 10 ditë pune.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave të administruara, Komisioneri konstaton se shkelja e kryer është mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, e provuar kjo jo vetëm nga pretendimet e ankuesit në ankesë por edhe nga konstatimi i grupit të inspektimit në zyrat e Autoritetit Publik.

Bazuar në pikën 4 të nenit 15 të këtij ligji mos trajtimi i kërkesës konsiderohet “refuzim”. Bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

“Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë”. Në zbatim të pikës 4 të nenit 19, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e nëpunësit i cili ka përgjegjësi administrative për moszbardhjen e dokumenteve me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, në rastin konkret Z. , me detyrë këshilltar juridik pranë kabinetit të Kryetares së Bashkisë.

Në këto kushte, kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në bazë të nenit 18 pika 2 gërma “a” sanksionohet me gjobë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Shoqatës “Intelektualët e Rinj Shpresë”, përfaqësuar nga Z. , nr. 949 datë 14.09.2016, kundër autoritetit publik/ Bashkia Shkodër, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e autoritetit publik/ Bashkia Shkodër, për vënien në dispozicion ankuesit, të kopjes së rregullores për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit mbikqyrës në lidhje me shoqërinë “Vllaznia” Sh.a.
3. Dënimin e Z. me gjobë në vlerën 150.000 (një qind e pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 19, pika 4 . Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Shkodër brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u dha sot në datë 21.09.2016.

